



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 82.1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 dhe nenin 5 parag. 1,2 të Rregullores së Ministrisë së Administratës Publike nr. 05/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave, merr:

### **VENDIM**

### **PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE TË PUNËSIMIT DHE TË ANKESAVE NË SHËRBIMIN CIVIL TË KOMUNËS**

#### **Neni 1**

Themelohet Komisioni për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në Institucionet e Administratës komunale, në përbërje :

1. Arsim Mehmeti, kryesues
2. Blerta Plakolli, anëtare

Anëtari i tretë i Komisionit caktohet ad hoc për çdo rast që zhvillohet procedurë sipas ankesës.

#### **Neni 2**

Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 dhe Rregulloren nr. 05/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave.

#### **Neni 3**

Komisioni themelohet në mandat dy vjeçar.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:  
*Anëtarëve të komisionit*  
*Zyrës së Personelit*  
*Arkivit*

**Nr. 02-020/04-0008976/18**  
**Podujevë, 08 shkurt 2018**



**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**